



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 282/5 prot.

Tiranë, më 22.7.2022

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 539, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Hysni Mulaj
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese;

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 8.7.2022, është njoftuar vendimi nr. 539, datë 8.6.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Hysni Mulaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63 pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 539, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Hysni Mulaj, prej vitit 1997 e në vijim, ushtron detyrën e prokurorit, aktualisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, dhe në zbatim

të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit për subjektin z. Hysni Mulaj ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni), ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit (në vijim referuar si DSIK) dhe raportin e vlerësimit profesional nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

2.1 ILDKPKI-ja, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, me anë të “*Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë për subjektin Hysni Mulaj*”, ka referuar për subjektin, se:

- i. *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, lidhur me burimin financiar të babait të subjektit;*
- iii. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- iv. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK-ja, bazuar në nenin 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, fillimisht, me anë të Raportit mbi kontrollin e figurës¹, ka referuar për subjektin e rivlerësimit: “*Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës*”. Në vijim, bazuar në të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, DSIK-ja ka përcjellë raportin e dytë të ndryshuar me nr. *** prot., datë **.12.2020², me anë të të cilit konstaton *papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit*.

2.3 KLP-ja, bazuar në nenin 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për kontrollin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Mulaj, ka hartuar një raport të hollësishëm, të cilin ia ka përcjellë Komisionit.

3. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

3.1 **Për vlerësimin e pasurisë.** Referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka hetuar dhe vlerësuar gjendjen pasurore të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, saktësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve periodike të interesave pasurorë, krahasuar me atë “Vetting”, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, të ardhurat, shpenzimet dhe pagimin e detyrimeve financiare, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit: [...] *ka përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore në drejtim të saktësisë së deklaratimit të pasurisë dhe justifikimit të burimeve të ligjshme dhe, për rrjedhojë, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni i është referuar edhe faktit se në analizën financiare, për periudhën 2003-2006, balancat negative janë të shtrira ndër vite, duke çmuar se, proporcionalisht, këto*

¹ Dërguar nga DSIK-ja me shkresën me nr. *** prot., datë **.11.2017.

² Deklasifikuar pjesërisht me vendimin e KDZH-së, nr. ***, datë **.12.2020.

konstatime nuk janë të mjaftueshme për t'u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm dhe që mund të çonte subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 [...]³.

4. Për kontrollin e figurës. Referuar nenit DH, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi ka administruar dhe verifikuar dosjet penale në funksion të vlerësimit të informacioneve të referuara në Raportin e DSIK-së, analizuar më tej në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale⁴, ndër të tjera, ka arritur në përfundimin se: [...] *Nga të dhënat e përditësuara nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit të ketë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar [...]*⁵

5. Për vlerësimin e aftësive profesionale. Referuar nenit E, të aneksit të Kushtetutës, nenit 43/2 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016, si dhe kreut II të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH", të ndryshuar, Komisioni, pasi ka analizuar Raportin e përgatitur nga KLP-ja, hetimin dhe vlerësimin e denoncimeve nga publiku, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe rekomandimin nga ana e relatorit të çështjes, ka arritur në përfundimin se: [...] *nuk u provua asnjë indicie apo element që cenon figurën e prokurorit Hysni Mulaj, sipas germës "a", të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar "i aftë" profesionalisht, për shkak se, pavarësisht problematikave të konstatuara, në vlerësimin tërësor të këtij kriteri, ka arritur një nivel kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me germën "c", të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016 [...]*⁶

6. Vendimi i Komisionit. Nisur nga përfundimet e mësipërme për secilin kriter kontrolli, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në nenin 58, pika 1, germa "a", dhe nenin 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit):

- Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Hysni Mulaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

7. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

8. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

9. Në krahasim me kompetencat e njohura për Komisionin dhe Kolegjin, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar

³ Për më tepër referohuni në f. 34, të vendimit të Komisionit.

⁴ Për më tepër referohuni në pikën 5, f. 39, të vendimit.

⁵ Për më tepër referohuni në f. 34-35, të vendimit.

⁶ Për më tepër referohuni në f. 42, të vendimit.

që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni.

10. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave të administruara.

11. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se nga shqyrtimi i vendimit nr. 539/2022 të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, paraqiten rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmon se ky vendim është i cenusshëm në tërësinë e tij, si dhe përmban shkaqe të mjaftueshme ligjore për t'iu paraqitur juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

12. Sa më sipër, bazuar në kërkesat e dispozitave të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit të posaçëm nr. 84/2016, konstatohet se përfundimet e arritura nga Komisioni nuk janë të drejta dhe në pajtueshmëri me provat e administruara.

13. Duke përfunduar, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 4 dhe 66 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ushtron ankim në tërësi ndaj vendimit nr. 539, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III. A. Për kontrollin e pasurisë

14. Për sa i takon rivlerësimit të kriterit të pasurisë, referuar nenit D, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik mban në konsideratë se, gjatë kryerjes së procedurave të rivlerësimit, objekti i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi, sipas nenit 179/b, të Kushtetutës, materializohet në kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklarimeve të subjektit ("Vetting" dhe ato periodike), ku në çdo rast subjekti i rivlerësimit duhet të deklarojë tërësinë e pasurisë së tij dhe shpjegojë bindshëm ligjshmërinë e burimit të krijimit të saj, si dhe ekzistencën e të ardhurave të ligjshme, sipas përkufizimit kushtetues.

15. Nga aktet e administruara dhe përmbajtja e vendimit të Komisionit, rezulton se gjatë hetimit administrativ të kriterit të pasurisë, subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar shpjegime dhe i është kaluar barra e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, pasi janë konstatuar problematika mbi saktësinë, mjaftueshmërinë dhe ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të.

16. Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në "*Deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie*" për vitin 2003, dhe në vijim në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën "Vetting" (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI, në datën **.1.2017. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatohet se:

17. Për pasurinë *Apartament banimi me sipërfaqe 101,4 m², ndodhur në Tiranë*

17.1 Në *D-Vett.*, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi me sipërfaqe 101,4 m² në “****”, blerë më **.1.2004, Tiranë. Vlera: 39.546 euro. Burimi i krijimit, në rubrikën e detyrimeve financiare, subjekti ka deklaruar: Në vitin 2004, babait tim, ***.**, i kam marrë një sasi prej 4.000.000 lekësh, për blerjen e apartamentit, me kusht që kur të përmirësohet gjendja ime financiare t’ia kthej, si dhe një sasi prej 500.000 lekësh në formë dhurate. Deklaratë noteriale nr. ****//** datë **.12.2011. Detyrimi i mbetur është deklaruar nga subjekti në shumën 1.780.000 lekë.

17.2 Në *DV- 2004*, subjekti ka deklaruar: Shtëpi banimi me sip. 101,4 m² në shumën 39.546 euro, apartament i pahipotekuar. Në rubrikën ku kërkohen të deklarohen detyrimet financiare, subjekti ka deklaruar detyrimin ndaj shitësit shumën 10.000 euro, si dhe detyrimin në shumën 4.000.000 lekë, ndaj babait ***.**, për blerje të apartamentit.

17.3 Në *DV – 2005*, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, subjekti ka deklaruar pagesën e këstit 10.550 euro për blerje apartamenti, paguar më datë **.2.2005, dhe në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale”, subjekti ka deklaruar shumën 500.000 lekë *cash*, marrë më **.1.2005, nga babai ***.**. Në të njëjtën deklaratë vjetore, subjekti ka deklaruar dhe pakësim të kursimeve *cash* nga viti 2004, shuma 700.000 lekë.

17.4 Në deklaratat periodike për vitet 2006-2010, subjekti ka deklaruar shlyerje pjesore të huas ndaj babait, në shumën totale rreth 2.000.000 lekë⁷. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se ka shlyer një pjesë të huas ndaj babait në vitin 2011, në shumën 120.000 lekë, por nuk rezulton ta ketë deklaruar këtë shlyerje detyrimi në Deklaratën periodike vjetore të këtij viti.

17.5 Në vlerësim të saktësisë së deklaramit dhe burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj pasurie, nga hetimi administrativ i Komisionit kanë rezultuar faktet si më poshtë:

17.6 Subjekti i rivlerësimit ka porositur apartamentin me sipërfaqe totale ndërtimi 101,4 m², me anë të kontratës së sipërmarrjes të datës **.1.2004, lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k., për vlerën 39.546 euro⁸. Palët respektive kanë përcaktuar se pagesa e apartamentit do të kryhej me këste, ku: (i) kësti i parë, prej 19.000 euro, të paguhet në datën e lidhjes së kontratës; (ii) kësti i dytë do të paguhet në përfundimin e rrethimit me tulla; dhe (iii) kësti i tretë do të paguhet në përfundim të suvatimit. Sipas akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se pagesat për blerjen e apartamentit janë kryer me tri këste pranë shoqërisë “****” sh.p.k., sipas mandatpagesave: (i) shuma 19.000 euro është paguar me mandatarkëtimin nr. **, datë **.1.2004; (ii) shuma 10.000 euro është paguar përmes mandatpagesës datë **.6.2004; dhe (iii) shuma 10.500 euro është paguar përmes mandatpagesës nr. **, datë **.2.2005.

17.7 Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me dy transaksione bankare (tërheqje *cash*), të kryera nga bashkëshortja e tij pranë *** Bank, të cilat, për nga koha dhe vlera, përkojnë me pagesën e kësteve të shlyera për blerjen e apartamentit,

⁷ Respektivisht 700.000 lekë në DV-2006, 350.000 lekë në DV-2007, 400.000 lekë në DV-2008, 350.000 lekë në DV-2009 dhe 300.000 lekë në DV-2010.

⁸ Sipas informacionit të marrë nga ASHK-ja Tiranë, kjo pasuri rezulton me status “regjistrim i përkohshëm”, në emër të subjektit të rivlerësimit, me sip. 91,9 m², i regjistruar në datën **.5.2021, me nr. pasurie **.

përkatësisht në datat **.1.2004 dhe **.2.2005⁹. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjet e datës 10.2.2022, ka shpjeguar se është vënë në dijeni mbi ekzistencën e kësaj llogarie në vitin 2016, nga ILDKPKI-ja¹⁰, duke sqaruar se nuk ka pasur dijeni për këtë llogari të shtetasë ***.*** (me të cilën në vitin 2007 ka lidhur martesë ligjore), dhe se kjo e fundit nuk ka kontribuar në blerjen e apartamentit në vitin 2004, pasi në atë kohë *nuk ka pasur njohje të niveleve të tilla konfidenciale me të.*

17.8 Referuar dokumentacionit të përcjellë nga ILDKPKI-ja¹¹, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime dy herë pranë këtij institucioni lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie. Në procesverbalin e datës **.12.2011, në përgjigje të kërkesës për dorëzim dokumentacioni ligjor në lidhje me huan e deklaruar në DV-2004, në shumën 4.000.000 lekë, marrë babait, si dhe me dhuratën e deklaruar në DV-2005, në shumën 500.000 lekë, marrë po babait, subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen nr. 3, ka deklaruar: *“Po ju dorëzoj deklaratën noteriale nr. *** Rep., dhe nr. *** Kol., datë **.12.2011 për dhuratën... dhe huamarrjen... me qëllim përballimin e shpenzimeve të blerjes së apartamentit të banimit”.*

17.9 Referuar përmbajtjes së deklaratës noteriale të vitit 2011, babai i subjektit të rivlerësimit, z. ***.***, ndër të tjera, ka deklaruar: se në janar të vitit 2004 i ka dhënë djalit të tij, Hysni Mulaj shumën 4.000.000 lekë për ta ndihmuar për të përballuar problemet e jetesës në Tiranë, me kushtin që kur të përmirësohet gjendja financiare e tij, t’i kthejë. Gjithashtu ka deklaruar se i ka dhuruar shumën 500.000 lekë në janar të vitit 2005, me burim nga të ardhurat dhe kursimet e tij personale.

17.10 Ndërsa në procesverbalin e datës **.1.2016, mbajtur pranë ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetjes nr. 2, ku i është kërkuar të sqarojë burimin e krijimit të huas së marrë babait, në shumën 4.000.000 lekë, ka deklaruar: *“Në lidhje me burimin e kësaj vlere nga ana e babait tim, sqaroj se një pjesë e mirë e këtyre të ardhurave janë nga paga ime si prokuror që nga viti 1997 dhe duke qenë se kam qenë në përbërje familjare së bashku me prindërit, të ardhurat e mia i ka administruar babai. Ky kontribut ka vazhduar deri rreth vitit 2002. Gjithashtu, familja jonë ka pasur në Tropojë të vjetër një lokal Bar kafe të vogël, e cila administrohej nga babai. Meqenëse prindërit e mi jetojnë akoma në Tropojë, e kisha akoma si detyrim që të kontribuoja për ta, prandaj, edhe këtë vlerë ia kam marrë si hua dhe do ia shlyeja me këste. Kam detyrim të palikuiduar akoma deri më datë 31.12.2014, shumën rreth 1,800,000 lekë”.*

17.11 Veç sa më sipër, lidhur me burimin e krijimit të huas, dhuratës dhe mënyrën e marrjes së tyre, gjatë hetimit administrativ të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ato janë marrë *cash*.

17.12 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, të datës 8.5.2020, përveç dy zërave të deklaruar në ILDKPKI (të ardhurat e tij nga paga dhe të ardhurat nga lokali bar-kafe e të atit), si burim krijimi të huas dhe dhuratës, ka deklaruar edhe *kontributin e*

⁹ Tërhequr në datën **.1.2004, shuma 2.007.644 lekë dhe në datën **.2.2005, shuma 1.500.000 lekë.

¹⁰ Referuar procesverbaleve të mbajtura në ILDKPKI, subjekti është pyetur, ndër të tjera, nëse ka pasur kontribut bashkëshortja e tij, znj. ***.***, në blerjen e apartamentit, kjo për faktin se në vitin 2003 ka pasur dy depozitime të kryera në *** Bank prej bashkëshortes, në vlerën 4.000.000 lekë. Në shpjegimet e tij, subjekti ka deklaruar se nuk ka dijeni lidhur me këto depozita dhe bashkëshortja nuk ka kontribut në blerjen e këtij apartamenti, pasi është martuar me të në vitin 2007.

¹¹ Shkresa e ILDKPKI-së me nr. *** prot., datë **.12.2021.

vazhdueshëm të të gjithë anëtarëve të familjes¹², duke specifikuar: (i) Kontributi i vazhdueshëm nga paga e subjektit; (ii) Të ardhurat nga aktiviteti i biznesit të babait; (iii) Pensionet e prindërve; (iv) Kontributet e vazhdueshme të vëllezërve, të cilët kanë qenë dhe janë të punësuar në administratën shtetërore (polici dhe bashki) dhe njeri në emigracion (Belgjikë); (v) Të ardhurat e siguruara nga administrimi i ekonomisë bujqësore në blegtori dhe pemëtari; (vi) Mbledhja e bimëve medicinale.

17.13 Komisioni, pasi ka analizuar në mënyrë të detajuar pretendimet mbështetur në aktet e vëna në dispozicion¹³, në rezultatet e para të hetimit administrativ, ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare të burimeve të ligjshme të huadhënësit, të ardhurat e prindërve nga pensionet për periudhën 1997 – 2003; të ardhurat nga paga e subjektit për periudhën 1997 – 2002; të ardhurat nga paga e vëllait ***.***, për periudhën 1996 – 2003; të ardhurat nga paga e vëllait ***.***, në Belgjikë, për periudhën 2003 – 2005, dhe shpenzimet e jetesës për personat e mësipërm, duke i kaluar barrën e provës subjektit të rivlerësimit, pasi ka konstatuar se: (i) Nga analizimi i burimeve të ligjshme të huadhënësit, duket se nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për dhënien e huas në vitin 2004 dhe dhuratës në vitin 2005; (ii) Nga analiza e kryer sa më sipër, ka rezultuar një balancë negative në shumën 4.174.505 lekë, për blerjen e pasurisë.

17.14 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij, ka kundërshtuar analizën e kryer nga ana e Komisionit, duke pretenduar përfshirjen e të ardhurave nga aktiviteti tregtar i të atit, të ardhurat nga aktiviteti bujqësor e blegtoral, të ardhurat e subjektit për vitet 2003 dhe 2004, si dhe rishikimin e shpenzimeve të jetesës, nisur nga fakti se familjarët kanë jetuar në fshat.

17.15 Komisioni, në rezultatet e hetimit shtesë, dërguar subjektit në datën 19.5.2022, duket se ka reduktuar shpenzimet e jetesës së subjektit dhe familjarëve të tij, duke konstatuar pamjaftueshmëri financiare vetëm për mbulimin e shumës 500.000 lekë, të deklaruar të dhuruar nga i ati i subjektit në vitin 2005, në masën – 472.025 lekë, pamjaftueshmëri për të cilën i është kaluar përsëri barra e provës subjektit të rivlerësimit.

17.16 Në prapësime të rezultateve të hetimit të datës 18.3.2022, subjekti ka shpjeguar se burimi i të ardhurave për blerjen e apartamentit janë huaja e marrë nga babai (i ndjeri ***.***), në të cilën përfshihen të gjitha të ardhurat e familjarëve, të deklaruara gjatë hetimit, si dhe të ardhurat e pagës së tij, të cilat **kanë vazhduar t'i jepen babait edhe pas vitit 2002**, duke kërkuar përlllogaritjen e të ardhurave nga paga e tij deri në vitin 2004. Subjekti në shpjegimet shtesë ka kërkuar në mënyrë të përmbledhur përfshirjen e të ardhurave nga aktiviteti i biznesit të babait, ekzistenca e të cilit konfirmohet nga autoritetet lokale, bazuar në vërtetimin e depozituar prej tij, si dhe kontrata e lidhur me OSHEE-në si abonent jo familjar (biznes)¹⁴, të ardhurat e realizuara nga ekonomia blegtorale dhe bujqësore, duke theksuar edhe mungesën e detyrimit të të vetëpunësuarit në bujqësi për tu regjistruar si tregtarë apo pajisjen me leje të posaçme për

¹² Pretendim, të cilin e bazon në faktin se familja e tij ka funksionuar si një familje e madhe, duke respektuar traditën e zonës, e cila drejtohej nga babai si kryefamiljar, dhe të gjitha të ardhurat e siguruara nga çdo anëtar i familjes administroheshin prej tij.

¹³ Trajtuar gjerësisht në f. 9-14, të vendimit.

¹⁴ Subjekti ka depozituar edhe dokumentacion shtesë si: Akt-ekspertimin për llogaritjen e të ardhurave nga aktiviteti i biznesit të babait, me metoda të tjera alternative, nga data e fillimit të aktivitetit *.1.1994 deri më *.12.2009; Vërtetimin nr. ** prot., datë *.3.2022, i lëshuar nga Ujësijellës-Kanalizime Tropojë, i cili konfirmon se nuk ka pasur rrjet për shpërndarje uji të pijshëm në Komunën Tropojë, fshati ***, për periudhën 1994 – 2004.

shitjen e produkteve bujqësore dhe blegtorale, që buronin nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, të përfutuar me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.

17.17 Sa i përket mënyrës së dërgesave të të ardhurave nga vëllai i cili jeton dhe punon në Belgjikë, subjekti, në prapësimet e tij datë 18.3.2022, ka shpjeguar se këto të ardhura janë dërguar nëpërmjet *** ***, të afërmeve dhe të njohurve, por, për shkak të kohës së gjatë, nuk është bërë e mundur të sigurohet ndonjë dokument vërtetues¹⁵.

17.18 Komisioni, në përfundim të sa më sipër, ndër të tjera, ka vlerësuar se të ardhurat e pretenduara si të përfuturara nga aktiviteti bujqësor dhe blegtoral mbeten në nivel deklarativ dhe të paprovuara me dokumentacion ligjor, e për rrjedhojë, këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare. Por duke qenë se produktet e përfuturara nga kultivimi i tokës bujqësore dhe blegtorial kanë shërbyer për konsum familjar, Komisioni ka vlerësuar të drejtë pretendimin e subjektit për uljen e shpenzimeve jetike në masën 50% për familjen e tij. Duke marrë në konsideratë të gjitha konstatimet e arsyetuara, të cilat passjellin pamundësi financiare për të justifikuar plotësisht me burime të ligjshme blerjen e apartamentit, sipas nenit D të aneksit të Kushtetutës, në raport edhe me deklaratimet e tjera që lidhen me kriterin e pasurisë, Komisioni ka vlerësuar se balanca negative e rezultuar nga analiza është në një masë të tillë që, duke qëndruar edhe si një shkak i vetëm, proporcionalisht, çmohet si e pamjaftueshme për ta çuar subjektin drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

18. Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike përshkruar si më sipër, për pasurinë *Apartament me sip. 101,4 m²*, çmon se përfundimi i arritur nga Komisioni është rrjedhojë e një vlerësimi jo të drejtë të provave, në raport kjo me ligjin e zbatueshëm dhe jurisprudencën e Kolegjit.

18.1 Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i akteve në dosje, vëren se në deklaratat periodike vjetore dhe atë Vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si huadhënës të shumës 4.000.000 lekë vetëm babain e tij, z. ***.***. Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj huaje, sikurse u përmend edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit, në procesverbalin e ILDKPKI-së, të janarit të vitit 2016, ka konfirmuar dhe saktësuar faktin se si burim krijimi i huas kanë shërbyer: *“... paga ime si prokuror që nga viti 1997 dhe duke qenë se kam qenë në përbërje familjare së bashku me prindërit, të ardhurat e mia i ka administruar babai¹⁶. Ky kontribut ka vazhduar deri në vitin 2002. Gjithashtu, familja jonë ka pasur në Tropojë të vjetër një lokal Bar Kafe të vogël, e cila administrohej nga babai...”*.

18.2 Subjekti i rivlerësimit, vetëm gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit të Komisionit të datës 8.5.2020, ka përfshirë si burim të huas së marrë prej tij edhe kontributin monetar të dhënë nga vëllezërit, shtetasit ***.***, ***.*** dhe ***.***.¹⁷

18.3 Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ për përfshirjen e kontributeve të vëllezërve të tij në analizimin e burimeve të ligjshme të huas që ka shërbyer për blerjen e pasurisë në pronësi të subjektit, nuk duket bindës dhe në harmoni me

¹⁵ Referohuni shpjegimeve të subjektit në prapësimet e rezultateve të dyta të hetimit administrativ.

¹⁶ Nga aktet në dosje ka rezultuar se, sipas certifikatës së lëshuar në datën **.12.202, përbërja familjare e subjektit të rivlerësimit për periudhën **.2.1991 deri në datën **.4.2007, paraqitet me tre persona, duke specifikuar se *“... *** nda 1991, Hysnia largue 2007, *** vdeke 2009”*.

¹⁷ Për të ardhurat e ligjshme të shtetasit ***.***, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur akte provuese.

provat e administruara. Rezulton se Komisioni ka përfshirë në analizën financiare në mesin e burimeve të ligjshme të huas të ardhurat e dy vëllezërve të subjektit, z. ***.*** dhe ***.***, edhe pse nga aktet e administruara konstatohet se:

- 18.3.1 Për të ardhurat e vëllait ***.***, emigrant në Belgjikë është administruar vetëm një kontratë pune, fotokopje dhe e përkthyer në gjuhën shqipe, akt i cili, i vetëm, nuk plotëson kushtet kumulative të parashikuara nga neni D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, pasi nuk provohet se për shumën e përfituar të jenë paguar detyrimet tatimore.
- 18.3.2 Për këto të ardhura nuk provohet as mënyra e sjelljes së tyre në Shqipëri apo të dhëna të tjera, si për shembull, përbërja familjare e siguresit/vëllait të subjektit, për të vlerësuar në mënyrë të besueshme mundësinë financiare për të kursyer dhe dërgimin e tyre në familjen e origjinës, në Shqipëri.
- 18.3.3 Për të ardhurat e vëllait tjetër, z. ***.***, bazuar në aktet në dosje, rezulton se ky shtetas është shkëputur nga certifikata familjare me subjektin prej vitit 1991, duke krijuar familjen e tij. Eventualisht, edhe në rast të përfshirjes së këtyre të ardhurave në mesin e burimeve të ligjshme të huas, në analizë do të duhej të llogariteshin edhe shpenzimet e jetesës sipas përbërjes familjare të z. ***.***.

18.4 Komisioneri Publik në këtë vlerësim mban në konsideratë edhe jurisprudencën e Kolegjit për raste të ngjashme, në të cilën për remitancat, ndër të tjera, është mbajtur qëndrimi:

Vendimi (JR) nr. 14/2021 [44. *Kolegji tashmë ka jurisprudencë të konsoliduar në drejtim të fakteve, të cilat do duhet të provohen, me qëllim që të justifikohen si të ardhura të ligjshme dhe, për rrjedhojë, të shërbejnë si burim i ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt kontrolli të ardhurat me burim emigracionin e subjektit të rivlerësimit apo të personave të lidhur me të. Në kuadër të qëndrimeve të mëparshme të Kolegjit lidhur me këtë çështje, të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit (të paidentifikuara në vlerë), me burim emigracionin e bashkëshortit në Greqi, **nuk provohen se përmbushin standardin e të ardhurave të ligjshme sipas nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, për sa kohë nuk rezultoi të jetë provuar niveli i këtyre të ardhurave, fakti që për to janë paguar tatimet në shtetin e origjinës, si dhe dërgesa e tyre nga vendi i origjinës në Shqipëri**, edhe në rast se, eventualisht, korrespondencat dhe fotot e sjella nga subjekti pranohen si prova të faktit të punësimit të bashkëshortit në shtetin grek, në periudhën e deklaruar [...].*

18.5 Duke përfunduar, për pasurinë *Apartament me sip. 104 m²*, Komisioneri Publik, vlerëson se të ardhurat e prindërve të subjektit të rivlerësimit, të cilat plotësojnë kriteret për t'u konsideruar si të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, në masën 559.078 lekë, për periudhën 1997-2003, janë të pamjaftueshme për të justifikuar huan e deklaruar në shumën 4.000.000 lekë, dhënë në vitin 2004, si dhe dhurimin prej 500.000 lekë, në vitin 2005.

18.6 Kjo situatë pamjaftueshmërie e burimeve të ligjshme për justifikimin e huas, konstatohet edhe po të përfshihen të ardhurat e subjektit të rivlerësimit për periudhën 1997-2002, në shumën 2.977.515 lekë, pa u llogaritur shpenzimet e jetesës për të njëjtën periudhë. Për pasojë, ndryshe nga sa ka vlerësuar Komisioni, çmujmë se subjekti i rivlerësimit për kriterin e kontrollit të pasurisë nuk e kalon testin e standardit kushtetues dhe ligjor të shpjegimit dhe provimit bindshëm të burimeve të ligjshme, sipas nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës,

për rrjedhojë, ai nuk arrin një nivel të besueshëm në vlerësimin e këtij kriteri, në referencë të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

19. Gjatë hetimit administrativ, nga analiza financiare për vitet 2003-2016, Komisioni ka konstatuar pamjaftueshmëri të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të mbuluar me burime të ligjshme kursimet dhe shpenzimet, përfshi këtu dhe shlyerjet e deklaruara të huas. Nga kjo analizë, ka rezultuar një balancë negative për të përbulluar shpenzimet, krijimin e likuiditeteve dhe pagesat për kthim huaje në vitet 2006, 2007, 2008 dhe 2010, në shumën totale - 1.593.250 lekë. Subjektit të rivlerësimit i është kaluar barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

19.1 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e datës 26.5.2022, ka pretenduar rishikimin e disa zërave të analizës financiare si: (i) rishikimin e kursimeve *cash*, duke ridekluar shtesat dhe pakësimet çdo vit të kursimeve *cash*¹⁸; (ii) rishikimin e shlyerjeve të huas, pasi kësti në vlerën 120.000 lekë është shlyer ndaj babait në vitin 2011; (iii) rishikimin e shpenzimeve familjare për vitet 2010 dhe 2011, duke pretenduar se për këto vite në deklarimin e shpenzimeve familjare ka konsideruar edhe kthimin e huas ndaj babait; (iv) rishikimin e shpenzimeve jetike në vitin 2005; (v) saktësimin e shpenzimeve të mobilimit të apartamentit.

19.2 Komisioni, pasi ka vlerësuar pretendimet e subjektit¹⁹, në përfundim, ka vlerësuar se për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të kanë pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme, përkatësisht për vitin 2005 në shumën -734.447 lekë; për vitin 2007 në shumën -600.365 lekë; për vitin 2010 në shumën - 153.586 lekë dhe për vitin 2014 në shumën -76.531 (ref. tabelës në f. 34 të vendimit), diferenca këto,²⁰ të cilat, arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, nuk i ka konsideruar si deklarim të pamjaftueshëm dhe që mund të çojnë drejt aplikimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

19.3 Komisioneri Publik, në analizë të akteve të administruara, konstaton se, përveç sa ka vlerësuar Komisioni si më sipër, duke u bazuar në deklaratimet periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit, si dhe jurisprudencën e Kolegjit, rezulton që subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet edhe për vitin 2006²¹.

19.4 Sa më sipër, në vlerësimin e Komisionerit Publik, pamjaftueshmëria financiare e konstatuar ndër vite, duhet marrë në konsideratë së bashku me mungesën e konstatuar të burimeve të ligjshme për pasurinë *Apartament*, në kuadër të vlerësimit të besueshmërisë së subjektit në vlerësimin e kriterit të pasurisë, për qëllim të nenit D të aneksit të Kushtetutës.

IV. Kërkimi i ankimit

20. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b/5 të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se, ndryshe nga sa disponon Komisioni i Pavarur i Kualifikimit për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan gjykim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë, në kuptim të nenin 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

¹⁸ Në përgjigje të Pyetësorit të datës 21.12.2021.

¹⁹ Trajtuar gjerësisht në f. 28-29, të vendimit.

²⁰ Shuma totale e diferencës negative është – 1.564.929 lekë.

²¹ Kjo diferencë vjen si rezultat i konsiderimit të shumës 300.000 lekë shpenzime mobilimi për këtë vit, sikundër deklaroi subjekti në fillim të hetimit administrativ.

21. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

22. Bazuar në kërkesat e neneve Ç, D, DH, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, të ligjit nr. 84/2016;

Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 539, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra e subjektit të rivlerësimit, zotit Hysni Mulaj.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO